DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-790/10
-VI-
Data Datum Date 22.07.2019

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo - Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| **Për :** | **Ragip Begaj**, Kryetar i Komunës së Malishevës<br>**Rrahim Morina**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës | |
| **Cc:** | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| **Përmes:** | **Adrijana Hodžić**, Ministre e MAPL-së<br>**Rozafa Ukimeraj**, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| **Nga:** | **Xhevat Tafa**, U.d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL | Datë:<br>17.07.2019<br>Nr. 020-790 |
| **Lënda:** | Konfirmim i ligjshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës | |
| **Lloji i aktit** | Vendim | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendim Nr. 02/396 për zbatimin e pikës 3 të vendimit nr.02/89 datë: 07.02.2019 i miratuar në mbledhjen e mbajtur me datë: 31.01.2019 |
| I miratuar më datë: 27.06.2019 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.07.2019 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **<u>është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALJESE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. / Br. / No. 020-790/10
-01-
Data / Datum / Date 22.07.2019

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo - Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| **Za:** | **Ragip Begaj**, gradonačelnik Opštine Mališevo<br>**Rrahim Morina**, predsedavjući Skupštine opštine Mališevo | |
| **Cc:** | Jedinici za administarciju dokumenata u MALS-u<br>Jedinici za administraciju dokumenata u opštini | |
| **Preko:** | **Adrijana Hodźić**, ministar MALS-a,<br>**Rozafa Ukimeraj**, generalna sekretarka MALS-a, | |
| **Od:** | Xhevat Tafa, v.d rukovodioca Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS | Datum,<br>17.07.2019<br>Br. 020-790 |
| **Predmet:** | Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Mališevo | |
| **Vrsta akta:** | Odluka | |

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka br. 02/396 za spovođenje tačke 3, Odluke br.02/89 od dana, 07.02.2019. godine, usvojena na sadnici održane dana, 31.01.2019. godine. |
| Usvojena dana, 27.06.2019. godine; |
| Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 05.07.2019. godine; |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je isti u saglasnosti sa zakonskim odrebama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak. Ministartsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date: 05.07.2019

| Njësia organizative | Nr. i Lëndës | Shtojca | Viera |
| --- | --- | --- | --- |
| -01 | 020- | 790 | |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës
Nr.02/226
Datë: 04.07.2019

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2, shkronja d, nenit 14 paragrafi 1, nenit 58 pika d, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), nenit 10, nenit 19, nenit 46 paragrafi 1,të Statutit të Komunës nr.01/871 të datës:12.11.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e -VII- (shtatë) të mbajtur me datë: 27.06.2019 merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet vendimi për zbatimin e pikës 3 të vendimit nr.02/89 datë:07.02.2019 i miratuar në mbledhjen e mbajtur me datë:31.01.2019.

2. Bazuar ne pikën 1 të këtij vendimi obligohet Drejtoria për Inspektorat që në afat prej 1 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi që billbordet-reklamat të cilat gjenden për momentin rreth parkut të qytetit në Malishevë duhet të largohen në tërësi, duke përfshirë edhe pastrimin e të gjitha reklamave tjera të vendosura për qëllime të ndryshme.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës përmes Drejtorisë për Inspektorat dhe Drejtorisë për Shërbime Publike.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit ne autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet
MAPL-së
Drejtorive të KK-së
Arkivit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Rrahim Morina

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË

PRANUAR ME: 28/03/2019

NUMRI: 02/203

| | | | |
|---|---|---|---|
| PËR: | Kuvendin Komunal Malishevë - Kryesuesin Rrahim Morina | | |
| PERMES: | Komisioni Komunal për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale Malishevë | | |
| NGA: | Kryesuesi i komisionit: Bashkim Krasniqi | | |
| LËNDA: | Kërkesë | | |
| DATA: | 28.03.2019 | Vendi: | Malishevë |

## K Ë R K E S Ë

Komisioni Komunal për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale Malishevë sipas kompetencave për të cilat është formuar ka mbajtur mbledhjen e radhës më date 14.03.2019, në të cilën mbledhje për rend dite ishte inicimi i procedurave sipas Vendimit Nr.02/89 të datës 07.02.2019 që ka të bëjë me Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Hapsirave Publike për Vendosjen e Reklamave në Qytetëzen e Malishevës.

Për inicimin e këtyre procedurave komisioni ka hasur në disa paqartësi në aspektin praktik. Prandaj me anë të kësaj shkrese kërkojmë edhe njëherë që të sqarohet se çka jep në shfrytëzim kuvendi komunal:

- Çka nënkupton sipërfaqja prej 288 $m^2$;
- Nëse është fjala për sipërfaqën e pronës komunale (tokës) atëherë a duhet që të dihet vendi apo vendet ku do të vendosën reklamat (billbordet) para se të shpallet ankandi;
- Çmimi prej 35 € për meter katror a nënkupton çmimin për sipërfaqën e tokës;
- Sipërfaqja prej 288 $m^2$, a duhet të ndahet në disa pjesë të barabarta apo të ndryshme dhe kush duhet ta bëjë këtë ndarje.

Prandaj, komisioni në mbledhjen e fundit duke analizuar këto paqartësi u pajtua që t'i bëjë kërkesë institucionit të lartëpërmendur për shqyrtim të metejme të kësaj çështje.

Me respekt

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës
Nr.02/ 81
Date. 07.02.2019

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2, shkronja (d), nenit 14 paragrafi 1, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), nenit 5 dhe 7 i Ligjit nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.35/17, dhjetor 2012) nenin 4 dhe 5 të Rregullores QRK nr.23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 5.2 të Ligjit nr.2003/11 për Rrugët, ("Gazeta zyrtare nr.16/01 Shtator 2007"), nenit 3 në lidhje me plotësimin dhe ndryshimin e nenit 5 paragrafi 5.2. të Ligjit nr.03/L-120 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.46/15 Janar 2009") për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rrugë nr.2003/11, nenin 19 dhe 46 të Statutit të Komunës nr.01/871 të datës 12.11.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e 1 (parë) të vitit 2019 të mbajtur me datë:31.01.2019 merr këtë:

# V E N D I M
## PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR

1. Miratohet kërkesa nr.02/62 e datës:28.01.2019 e parashtruar nga Komisioni Komunal për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, për përsëritjen ankandit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të hapësirave publike për vendosjen e reklamave në qytezën e Malishevës.

2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi hapësirat për vendosjen e reklamave do të jenë në sipërfaqe prej 283m², në pjesët e ngastrave kadastrale në Zonën Kadastrale në Malishevë P.SH Rrugët si në vijim:
Njësia kadastrale nr. P-72310047-00893-2 në pjesën e sipërfaqes nr.4469 m² zk.Malishevë
Njësia kadastrale nr. P-72310047-01423-0 në pjesën e sipërfaqes nr.36553 m² zk. Malishevë
Njësia kadastrale nr. P-72310047-01430-1 në pjesën e sipërfaqes nr. 28775 m² zk. Malishevë
Njësia kadastrale nr. P-72310047-01428-0 në pjesën e sipërfaqes nr.36880 m² zk. Malishevë

3. Me këtë vendim billbordet-reklamat të cilat gjenden për momentin rreth parkut të qytetit në Malishevë duhet të largohen në tërësi, duke përfshirë edhe pastrimin e të gjitha reklamave tjera të vendosura për qëllime të ndryshme, kurse billbordet e reja për vendosje të reklamave duhet te vendosen në 4 hyrjet e rrugëve kryesore të qytetit të Malishevës.

4. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës paluajtshme është krijimi i mundësive për të hyra publike në buxhetin e Komunës së Malishevës.

5. Afati kohor i dhënies së pronës së paluajtshme komunale, të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është afatshkurtër në periudhë kohore 2 (dy) vite, ndërsa çmimi bazë do të jetë 35€ (tridhjetë pesë euro) për metër katror për secilin vit, ndërsa në procedurë të ankandit do të përzgjidhet oferta ekonomikisht më e favorshme për Komunën.

6. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Malishevës dhe si e tillë nuk mund t'i jepet në shfrytëzim personit të tretë nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër.

7. Obligohet komisioni për vlerësimin e ofertave që në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, dhe Rregulloren (QRK) nr.23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, t'i zhvilloj procedurat e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër.

8. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.

9. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës përmes organeve kompetente.

10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:
MAPL-së
Drejtorive të KK-së
Arkivit të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit
[illegible]